

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRRETHIT TIRANË

NR. 15816

15816

V E N D I M

PËR RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot në datën 6/09/ 1996, unë gjyqtarja e Gjykatës së rrethit
Tiranë Morjana Jodi, si shqyrtova kërkesën e kërkuarit
Diogjen Qeva i cili kërkon të rregjistrojë shoqërinë me përgjegjësi
të kufizuar " JONI " SH.P.K., si person juridik

K O N S T A T O V A :

Kërkuari Diogjen Qeva kërkon të rregjistrojë si person
juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " JONI " SH.P.K. me
seli në fshatin Vërdovë të rrethit Pogradec , me cilësinë e ortakut të
vetëm , me administrator Diogjen Qeva , me kapital fillestar 100.000
lekë , me kohëzgjatje mbi 10 vjet dhe me objekt veprimtarie në fushën
e shfrytëzimit , përpunimit e transportit të lëndës drusore e të produ-
kteve të tjera prej druri, si dhe të tregëtisë të artikujve industriale
dhe ushqimore me shumicë dhe pakicë, import eksport etj.

Kërkesa e tij është e drejtë dhe si e tillë pranohet.

PËR KËTO ARËSYE :

Në bazë të Ligjit Nr. 7638 datë 10.11.1992 " Për shoqëritë
tregëtare " dhe të Ligjit Nr.7667 datë 28.1.1993 " Për rregjistrin
tregëtar "

V E N D O S A :

Të rregjistroi si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi
të kufizuar " JONI " SH.P.K., me seli në fshatin Vërdovë të rrethit
Pogradec , me cilësinë e ortakut të vetëm , me administrator Diogjen
Qeva , me kapital themelues 100.000 lekë, me kohëzgjatje mbi 10 vjet
dhe me objekt veprimtarie në fushën e shfrytëzimit, të përpunimit dhe
transportit të lëndës drusore dhe të produkteve të tjera prej druri,
si dhe të tregëtisë të artikujve industriale dhe ushqimore me shumicë
dhe pakicë, import eksport etj.

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallën e dytë.

G J Y Q T A R E

1 Morjana Jodi 1
Morjana Jodi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR: 15816/1

V E N D I M
I GJYQTARES SE VETEM .

Sot, ne daten 14/01/2000, une gjyqtare e Gjykates serrethit Tirane M. Jeli, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Diogjen Qeva , i cili kerkon depozitimin e vendimit te Ortakut te vetem per shtese objekti te shoqerise " JONI " SHPK

K O N S T A T O V A

Me vendimin nr. 15816 date 6 shtator 1996 te Gjykates se Rrethit ~~Kraguje~~ Tibrane , eshte person si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " JONI " SHPK ? ME ORTAK E ADMINISTRATOR Diogjen Qeva, me kapital 100.000 lek , me seli ne fshatin Verdove - Pogradec,

Me vendimin nr. 1 date 10 Janar 2000 te Ortakut te vetem eshte vendosur shtese objekti edhe ne fushen e pyllezimeve, permiresimit pyjor, shfrytezimin e pyjeve, rruget pyjore, ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe, Shtese behet nen enin 9 te Statut te Shoqerise " JONI " SHPK

Kerkesa per te pasqyruar ndryshimet qe kane ndodhur ne shoqeri ne skeden perkatese te kesaj shoqerie, eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.


PER KETO ARESYE :

Ne baze te Ligjit nr. 7667 date 23.01. 1993 per regjistrin tregeter e formalitet qe duhen plotesuar ne te

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses se kerkuesit Diogjen Qeva te Shoqerise " Joni " SHPK per depozitimin e vendimit te ortakut te vetem date 10. 01. 2000, ku eshte vendosur shtesa e objektit ne fushen e pyllezimeve, permiresimit pyjor, shfrytezimin e pyeve, rruget pyjore, ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe. Te behen ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen 2, germa "C" e ne kollonen 4 e 5 me nr. rendor 2 si dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

Maysina Jeli


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE:
NR: 15816/2, Vendimi.

V E N D I M
I G J Y Q T A R E S S E V E T M E

Sot ne daten 17-03 2005, une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare.
Rrethit Tirane Dr. Muz, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit
Diogjen Qeva, i cili kerkon depozitim e vendimit te ortakut te vetem per shtese objekti
te shoqerise „JONI“ SH.P.K.

K O N S T A T O V A

Me vendimin nr. 15816 date 6 Shtator 1996, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane,
eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar „JONI“ Sh.P.K. me
Ortak e Administrator z. Diogjen Qeva, me kapital 100.000lek, me seli ne fshatin Verdove
Pogradec.

Me vendimin nr.2 date 21.Shkurt.2005 te Ortakut te Vetem eshte vendosur shtese
objekti ne nenin 9 te Statutit te Shoqerise „JONI“ Sh.P.K.

NE FUSHEN E STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE

1. Per hartimin e planeve e te menaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
2. Per hartimin e projekteve e te pyllizimit
3. Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve..
4. Per hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrueshem te pyjeve.
- 5 Per hartimin e projekteve te menaxhimit te pellgjeve ujembledhes

NE FUSHEN E ZBATIMIT TE PUNIMEVE PYJORE

1. Per pyllzime (fidanishtet, grumbullimin e trajtamin e farerave pyjore, punimet pergatiore , mbjellje fidanash)
2. Per perimiresimin e pyjeve(ricungimin e trajtim pyjesh me prerje kulturore)
3. Per shfrytezimin e qendrueshem te pyjeve.
- 4 Per sistemimet malore.
5. Per ndertimin e rrugeve pyjore.
6. Per ushtrimin e gjuetise sportive e turistike te faunes se eger.
7. Per mbrojtjen nga semundjet, demtuesit dhe zjarret.
8. Per punimet ne kullota e livadhe dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe.
9. Punime ne zonat e mbrojtura.
10. Tranzitim , perpunim dhe shperndarje e druve te zjarrit, solarit, etj .
11. Te kryeje punime ne fushen e pyjeve dhe ne pyjet komunale.

NE FUSHA TE NDRYSHME

Ne fushen e tregtimit te pjeseve te kembimit per makineri e automjete, plehra kimike.. hapje pika servisi, lavazho, agjensi turistike, bar- bufe, restorante, motel, transport mallrash dhe pasagjeresh.

Ne perfundim meqenese se kerkesa dheaktet e tjera jane te bazuara ne ligj e si te tillat duhen pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7667 date 28.01.1993 per "Regjistrin Tregetar"

V E N D O S A

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimn e Vendimit Nr. 2 date 21.02.2005, te Ortakut te Vetem te Shoqerise "JONI" SH.P.K., per shtese objekti ne:

NE FUSHEN E STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE

1. Per hartimin e planeve e te menaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
2. Per hartimin e projekteve e te pyllizimit
3. Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve..
4. Per hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrueshem te pyjeve.
- 5 Per hartimin e projekteve te menaxhimit te pellgjeve ujembledhes

NE FUSHEN E ZBATIMIT TE PUNIMEVE PYJORE

1. Per pyllzime (fidanishtet, grumbullimin e trajtamin e farerave pyjore, punimet pergatiore , mbjellje fidanash)
2. Per perimiresimin e pyjeve(ricungimin e trajtim pyjesh me prerje kulturore)
3. Per shfrytezimin e qendrueshem te pyjeve.
- 4 Per sistemimet malore.
5. Per ndertimin e rrugeve pyjore.
6. Per ushtrimin e gjuetise sportive e turistike te faunes se eger.
7. Per mbrojtjen nga semundjet, demtuesit dhe zjarret.
8. Per punimet ne kullota e livadhe dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe.
9. Punime ne zonat e mbrojtura.
10. Tranzitim , perpunim dhe shperndarje e druve te zjarrit, solarit, etj .
11. Te kryeje punime ne fushen e pyjeve dhe ne pyjet komunale.

NE FUSHA TE NDRYSHIME

Ne fushen e tregetimit te pjeseve te kembimit per makineri e automjete, plehra kimike., hapje pika servisi, lavazho, agjensi turistike, bar- bufe, restorante, motel, transport mallrash dhe pasagjeresh.

-Urdherimin e Zyres se Regjistrin Tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen____, germa_____.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYOTARE
[Signature]

Unaltes registri

15816

1.

2.

a) "Juni"

b) Pogradec "Fshah Vërdorë"

c) Gllpytzumi, fshpim, leuolë dranse.

si dhe trefsh prodhata industriale shp.

d) 100.000 leku NR 076517 dt 30/8/1996
BK.T. Pogradec.

3. Administrator Drogjen Qever dt 1968

komes Vërdorë Pogradec

= 10 x jet.

4. Akti themeluesit : 1 fletë
Statuti : 4 fletë

5. Data e nënshkrimit :

5/08/1996

6/08/1996

QYQJTARE

Mangush Jodi
Mangush

A K T T H E M E L I M I

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7512 datë 10.8.1991 " Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe të nismës së lirë...", unë i quajtura Diogjen Zarif Qeva , me cilësinë e ortakut të vetëm, vendosa të krijoi Shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar " JONI " SH.P.K., për të zhvilluar veprimtari private në fushën e shfrytëzimit , përpunimit e transportit të lëndës drusore e të produkteve të tjera prej druri, si dhe të tregëtisë të artikujve industriale dhe ushqimore me shumicë dhe pakicë, import eksport etj.

Kapitali bazë i themelimit të shoqërisë është 100.000 lekë dhe kohëzgjatja e shoqërisë është mbi 10 vjet . Selia e shoqërisë do të jetë në fshatin Vërdovë të rrethit Pogradec dhe Administrator i shoqërisë është zoti Diogjen Qeva . Përfaqësia e shoqërisë ndaj të tretëve do të bëhet nga vetë administratori dhe konfliktet midis palëve do të zgjidhen në gjykatën e rrethit Tiranë.

Cdo aktivitet dhe veprimtari e shoqërisë që do të kryhet , parashikohet në Statutin e kësaj Shoqërie , i cili do të depozitohet në Gjykatën e rrëgjistrir tregëtar Tiranë.

Pogradec më 4.9.1996

ORTAKU THEMELUES
ADMINISTRATORI

(Diogjen Qeva)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA POGRADEC
Nr. 4135 Rep.

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot në datën 5.9.1996 u paraqit para meje Notere Burbuqe Sala personalisht zoti Diogjen Qeva , i datëlindjes 22.1.196 me banim në fshatin Vërdovë të rrethit Pogradec, madhor dhe i aftë për të kryer veprime juridike , për identitetin e të cilit u sigurova nga letër njoftimi personal , i cili deklaroi se firma në këtë akt themelimi është e tij, pra vërtetoj firmën.

NOTERIA POGRADEC
NOTERE BURBUQE SALA
TEL.NR.382



NOTERE

Burbuqe Sala

Sala



S T A T U T I

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " JONI " SH.P.K.

Shoqëria tregëtare " JONI " SH.P.K. krijohet në bazë të Aktit të themelimit të bërë nga ortaku i vetëm zoti Diogjen Qeva, lindur dhe banues në fshatin Vërdovë të rrethit Pogradec, në Republikën e Shqipërisë. Kjo shoqëri krijohet në mbështetje të ligjit Nr. 7512 datë 10.8.1991 " Për saksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarisë private të pavarurr ...", si dhe në bazë të Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregëtare " si dhe në bazë të dokumentave kryesore si akti i themelimit dhe statuti i shoqërisë.

NENI 1

Zoti Diogjen Qeva me kapitalin e vet do të krijojë aktivitet tregëtar në fushën e shfrytëzimit, përpunimit dhe transportit të lëndës drusore dhe produkteve të tjera prej druri, si dhe në aktivitetin tregëtar të artikujve industriale dhe ushqimore me shumicë dhe pakicë, import eksport. Kjo firmë tregëtare rregjiqtrohet për herë të parë në gjykatën e rregjistrimit tregëtar në Tiranë dhe është person juridik me emërtimin "JONI" SH.P.K.

Kjo shoqëri tregëtare e ka qendrën e selisë në fshatin Vërdovë të rrethit Pogradec dhe kryen aktivitet tregëtar si brenda dhe jashtë rrethit. Gjithë dokumentat e shoqërisë si akte, fatura, kontrato, njoftime dhe publikime, do të mbajnë adresën e kësaj shoqërie, numurin e rregjistrimit tregëtar të gjykatës dhe atë rregjistrimit në organet tatimore të rrethit.

NENI 2

Shoqëria " JONI " SH.P.K. e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bazë të Statutit të saj i cili përcakton rregullat e përgjithshme të organizimit të veprimtarisë, mënyrën e administrimit të fitimeve, kohëzgjatjen dhe mbylljen e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me kërkesat ligjore.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë tregëtare të shoqërisë " JONI " SH.P.K. është në fushën e shfrytëzimit, përpunimit e transportit të lëndës drusore e të produkteve të tjera prej druri si dhe për tregëtimin e artikujve të ndryshëm industriale dhe ushqimore me shumicë dhe pakicë etj. Import eksport.

NENI 4

KAPITALI BAZË I SHOQËRISË

Kapitali bazë për themelimin e shoqërisë është në shumën

100.000 lekë.

Neni 5

Kapitali bazë i themelimit të shoqërisë sipas nenit 4 të këtij Statuti është depozituar nga pronari i shoqërisë në të holla në bankën Kombëtare Tregëtare Pogradec. Në librin e llogarive të shoqërisë shënohet krijimi i kapitalit themelor si dhe gjithë kapitalet e vëna nga pronari për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë.

Në përputhje me ecurinë e shoqërisë, pronari ka të drejtë të rrisë ose të pakësojë; kontributete e vëna në kapitalin bazë, ndryshime të cilta shënohen edhe në librat e llogarisë si dhe njoftohet organi tatimor ku është rregjistruar shoqëria.

NENI 6

Shoqëria është pronare e pasurisë dhe e të ardhurave të saj. Administratori i shoqërisë ka të drejtë të disponojë dhe të përdorë këtë pasuri në përputhje me objektin e veprimtarisë që kryen me përjashtim të kufizimeve të vëna me ligjë.

NENI 7

Shoqëria cakton vetë çmimet e mallrave që do të tregëtojnë me përjashtim të atyre që caktohen kufi nga organet kompetente të ligjës, të cilat respektohen detyrimisht.

NENI 8

Për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, pronari i saj është dhe administrator i shoqërisë, i cili ka të drejtë të marrë kredi nga Banka e shtetit Shqiptar ose subjekte të tjera të njohura me ligjë, të lidhë kontrato me subjekte shtetërore apo private për sigurimin e lëndëve të para, shitjen e tyre, të paraqitet në procesin e privatizimit të njësive shtetërore për të siguruar objekte të nevojëshme për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit sipas mënyrave të përcaktuarar me ligjë. Të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me subjekte të tjera vendase apo të huaja, të blejë aksione në subjekte e shoqëri të tjera etj.

NENI 9

Shoqëria krijon fondin rezervë të saj, fondin e amortizimit dhe fonde të tjera për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së shoqërisë që caktohen nga administratori i saj. Detyrimet që lindin nga veprimtaria e shoqërisë mbulohen nga fitimet, nga fondet rezervë, nga fondet e tjera apo shumat suplementare që derdh pronari i saj, kur detyrimet nuk përballohen nga fondet ekzistuese.

NENI 10

Të ardhurat nga veprimtaria e shoqërisë ndahen në këtë mënyrë :- Nga të ardhurat bruto zbriten shlyerje kredie, amortizimi, shpenzimet për blerje mallra e materiale, transporti e shpenzime të

ndryshme prodhimi , pagat dhe shtesat mbi paga , uji dhe energjia elektrike , reklama, taksa e tatime dhe fonde të tjera financimi, dhe pjesa që ngelet disponohet nga pronari i shoqërisë.

NENI 11

Veprimtaria ekonomiko financiare e shoqërisë pasqyrohet në librat e dokumentat e përcaktuara financiare , sipas mënyrës së caktuar nga Ministria e Finacave dhe nga organet tatimore.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 12

Organi vendimor dhe operativ i shoqërisë është Administratori i saj , i cili merr vendime për shtimin dhe pakësimin e kapitalit bazë të themelimit të shoqërisë , aprovon statutin e saj dhe bën ndryshimet e nevojshme , përcakton strukturën e organizimit të shoqërisë , emëron personelin dhe punonjësit e saj , vendos për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë, riorganizimin e saj ose bashkimin e kapitaleve me subjekte të tjera vëndase apo të huaja, marrjen e kredive . Përfaqëson shoqërinë para të tretëve në gjykatë , arbitrazhe , emëron përfaqësues të shoqërisë për çështje të ndryshme , organizon punën e përditëshme , largon nga puna punonjësit në kushtet e parashikuara me ligj apo me kontrato . Në përputhje me nevojat e punës dhe të organizimit ai ka të drejtë të emërojë Drejtor , i cili organizon punën e përditëshme të shoqërisë dhe e përfaqëson atë duke gëzuar edhe të drejta të tjera me autorizim të administratorit të shoqërisë.

NENI 13

Marrëdhëniet e punës brenda shoqërisë rregullohen nga kontratota e punës , nga legjisllacioni dhe aktet e tjera ligjore. Rregulli i brendshëm në punë bëhet me urdhër të administratorit ose të drejtorit kur ka të emëruar të tillë. Punëdhënësi detyrohet të sigurojë punëmarrësin që ai të përfitojë nga ligji i sigurimeve shoqërore.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

NENI 14

Shoqëria tregëtare do të zhvillojë një aktivitet mbi 10 vjet mbyllja e saj mund të bëhet para këtij afati për shkaqe të justifikuara dhe gjithmonë me vendim të administratorit të shoqërisë. Kur shoqëria nuk figuron rentabël për më tepër se tre muaj , administratori mund të mbyllë aktivitetin.

NENI 15

Kur shoqëria mbyll aktivitetin , administratori cakton komision likuidimi , i cili paraqet bilanç likuidimi , i cili pasi të miratohet , atohere ajo shoqëri mbyll aktivitetin e saj.

Kur shoqëria mbyll aktivitetin dhe pasi janë shlyer detyrimet ndaj shtetit dhe të tretëve , pjesa e mbetur në kapitalin themelor dhe e të ardhurave të realizuara , disponohen nga pronari i shoqërisë i cili i përballon të gjitha detyrimet në rast të një bilançi negativ. Shoqëria mund të mbyllë aktivitetin e saj edhe në formën e riorganizimit .

ENI 16

Në formën e riorganizimit shoqëria mbyll veprimtarinë me krijimin e ndërmarjes apo të shoqërisë së përbashkët me subjekte të tjera private apo shtetërore , vëndase apo të huaja . Në këtë rast shoqëria ruan thelbin e aktivitetit të përcaktuar në këtë statut dhe subjekti i përbashkët e zhvillon aktivitetin në bazë të kontratos apo të statutit të pranuar nga palët në marrëveshje , në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të bëjë ndryshimet e nevojëshme në objektin e veprimtarisë , të cilat i depoziton në gjykatë apo; në organin tatimor.

Ky statut u përpilua në tre kopje.

Pogradec, më 4.9.1996

ADMINISTRATORI
(Diogjen Qeva)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA POGRADEC

Nr. 4136 Rep.

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot në datën 5.9.1996 u paraqit para meje Notere Burbuqe
Sala personalisht zoti Diogjen Qeva i datëlindjes 22.1.1968
lindur dhe banues në fshatin Vërdovë të rrethit Pogradec, madhor dhe
i aftë për kryer veprime juridike , për identitetin e të cilit u siguro-
va nga letër njoftimi personal , i cili deklaroi se firma në këtë
statut është e tij, pra vërtetoi firmën.

NOTERIA POGRADEC
NOTERE BURBUQE SALA
TEL. NR. 382



NOTERE

Burbuqe Sala

Sala

M A R R E V E S H J E

MIDIS

DEGES BANKES KOMBETARE TREGETARE TE SHQIPERISE

NGA ... *Banka e ...* ... *Lipo...*

DHE

PERMALSUESIT TE *Banka e ...* SH.P.K (në krijim e sipër)

Zotit. *Drejtori ...*

Me objekt:

Rregjistrimi juridik të fondeve të depozituara për llogari të shqërisë *Banka e ...* SH.P.K (në krijim e sipër).

Palet bien dakort si më poshtë:

1. Përfaqësuesi depoziton pranë Degës Bankes Kombetare Tregtare të Shqipërisë prej *100.000.000.000* lekësh ose USD, për llogari të shqërisë *Banka e ...* SH.P.K (në krijim e sipër).

Kjo shumë do të rrijë e bllokuar në këtë llogari jo më tepër se një muaj (afat brenda të cilit gjykata është e detyruar ligjërisht të vendosë në lidhje me kërkesën e aplikantit) deri sa nga ana e tij të paraqitet ndërkohë gjithë dokumentacionit të kërkuar nga Banka edhe vendimi i rregjistrimit në gjykatë.

2. Dega e Bankes Kombetare Tregtare të Shqipërisë pranë depozitimit të shumës së nësipërme duke i dhënë depozituesit (Përfaqësuesit) Certifikatën e depozitimit të fondeve në qëllim që të paraqesë atë në gjykatën përkatëse.

3. Në rast se përfaqësuesi kërkon të tërheqë shumën e sipërmendur pa paraqitur dokumentacionin e kërkuar në sipër duhet të kthejë abrapsh të certifikatën origjinale që i është dhënë atij për ta paraqitur në gjykatë.

4. Për shërbimin që Banka do të kryejë do të zbatohen kushtet:

- a. 500 lekë per SH.P.K me kapital teresisht shqipëtar dhe
 - b. 50 USD per shoqëritë e përbashkëta (SH.P.K) me kapital
- të huaj, pa varsisht nga raportet që kane perqindjet e kapitalit ndaj partnerëve..

5. Kjo marreveshje nënshkruhet ne dy kopje prej të cilave secila nga palët merr nga nje..


Popodene 30. qersht. 1996.

PRERF. QLSUESI

Diagjën Qera

DLGA B.K.T.SH. *Popodene*

Lejten
p Bardhyt Lipo
Lipon



Ç E R T I F I K A T E

Me anë të kësaj Çertifikate vërtetojmë se z. *Siqjan Dera*...
ka depozituar pranë Bankës sonë shumën prej *100.000.000* lekësh ose
.....USD. *M.A. N1076517* dt. *30 gusht 1996*

Ky depozitimi bëhet për efekt të dorëzimit të kapitalit fillor
tard të Shoqërisë «*Teuta*»... SH.P.K (në krijim e sipër).

Pajisje: No. *30 gusht*.../1996

D R E J T O R I

P (Bordyl Apo)



15816/1

K E R K E S E

KERKUESI : Diogjen Qeva i datlindjes 1963 lindur e banues ne fshatin Verdove Pogradec, madhor mezotesi te plote per te vepruar., me cilesine e admin stratorit shoqeris JONI

OBJEKTI : Depozitim e vendimit te Ortakut te vetem per shtese objekti te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " JONI" SHPK date 10 Janar 2000.

GJYKATES SE RRETHIT
T I R A N E

Me vendimin nr. 15816 date 6 shtator 1996 te Gjyka es se rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me p r- gjegjesi te kufizuar " JONI " shpk me ortak e administrator z. Diogjen Qeva , me kapital 100.000 lek, me seli ne fshatin Verdove Pogradec.

Me vendimin nr. 1 date 10 Janar 2000 te Ortakut te vetem eshte vendosur shtesa edhe ne fushen e Pyllezimeve, permiresimit pyjor, shfrytezimin e pyjeve rruge pyjore ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe!

Kerkoj te behen keto ndryshime ne skeden e kesaj shoqerie.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE POGRADEC
NR! 65 rep.

KERKUESI
DIOGJEN QEVA.

VERETIMI NENSHKRIMI.

Ne Pogradec, sot ne daten 12 janar 2000 para meje Noter Thoma Bicja u paraqit personalisht kerkuesi Diogjen Qeva i datl. 1968 banues ne Pogradec, per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leternjoftimit pkates i cili nenshkroi para mejekerkesen sa me siper.

N O T E R
THOMA BICJA



REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA " JONI " SHPK

V E N D I M

I ORTAKUT TE VETEM .

Me vendimin nr. 15816 date 6 shtator 1996 te Gjykates se rrethit Tirane, eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " JONI " SHPK me ortak e administrator z . Diogjen Qeva , me kapital 100.000 lek me seli ne fshatin Verdove.

Sotm ne daten 10 Janar 2000.

V E N D O S A :

Te shtohet objekti edhe ne fushen e pyllezimeve, permiresimit pyjor, shfrytezimin e pyejeve, rruget pyjore, ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe e nenin nr. 3 te Statutit te Shoqerise.

ORTAKU I VETEM

DIOGJEN ZARIF QEVA



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA POGRADEC

VERTETIM NENSHKRIMI.

Vertetoj se sot ne daten 10 janar 2000, para meje Noter, Thoma Bicja u paraqit personalisht Diogjen Zarif Qeva i datl. 1968 banues ne fshatin Verdove, madhor me zotesi te plote per te vep-ruar, per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leternjoftimit personal, i cili deklaroi se firma ne kerkesen sa me sipet eshte e tija.

NOTERI
THOMA BICJA



15816/2

T. KUCI

J. B. Mues

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA „JONI „ SHPK- POGRADE
K E R K E S E

16 03 2005
MARS 2005
Shani

KERKUESI Diogjen Qeva i biri i Zarifit i datlindjes 1968 lindur dhe banues ne Verdove- pogradec, administrator i shoqerise „JONI „ SHPK Pogradec;

O B J E K T I . Depozitim i Vendimit te Ortakut te vetem te Shoqerise „ JONI „ SHPK nr. 2 date 21 shkurt 2005, per shtese te objektit te veprimtarise se shoqerise.

Baza ligjore : Neni 21 i Ligjit nr. 7632 date 04. 11. 1992 .

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR
T I R A N E

Me vendimin nr. 15816 date 06 shtator 1996 j te Gjykates se shkalkles se Pare Tirane, kam bere regjistrimin e shoqerise „ JONI“ SHPK si person juridik privat, me Ortak te vetem dhe administrator une kerkuesi Diogjen Qeva.

Per shkak se veprimtaria e kesaj shoqerise eshte zgjeruar, kerkoj qe te bej shrese te objektit te veprimtarise te kesaj shoqerise sipas vendimit nr. 2 date 21 shkurt 2005 te vendimit te Ortakut te vetem, vendim i bazuar edhe ne Lejen profesionale te leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e pyjeve dhe kullotave (komisioni i lejave profesionale), leshuar shoqerise „ JONI „ SHPK me drejtues teknik z. Qani Bushi me leje profesionale nr. 141., regjistruar neregjistrin themeltar nga data 02 korrik 2003, leje e vlefshme deri ne daten 02 korrik 2006.

6. depoziti te let
akti dt
17-03-05
Shani

NE FUSHEN E STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE :

1. Per hartimin e planeve e te menaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
2. Per hartimin e projekteve e te pyllizimit
3. Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve .
4. Per hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrueshem te pyjeve.
5. Per hartimin e projekteve te menaxhimit te pellgjeve ujembledhes

Vendim i Ortakut nr
Viteen Nr 2 dt
21-02-03

NE FUSHEN E ZBATIMIT TE PUNIMEVE PYJORE

1. Per pyllfolljezime (fidanishtet, grumbullimin e trajtamin e farerave pyjore, punimet pergatiore , mbjellje fidanash)
2. Per perimiresimin e pyjeve(ricungimin e trajtim pyjesh me prerje kulturore)
3. Per shfrytezimin e qendrueshem te pyjeve.
4. Per sistemimet malore.
5. Per ndertimin e rrugeve pyjore.
6. Per ushtrimin e gjuetise sportive e turistike te faunes se eger.
7. Per mbrojtjen nga semundjet, demtuesit dhe zjarret
8. Per punimet ne kullota e livadhe dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe.
9. Punime ne zonat e mbrojtura
10. Tranzitim , perpunim dhe shperndarje e druve te zjarrit, solarit, etj .
11. Te kryeje punime ne fushen e pyjeve dhe ne pyjet komunale.

Leje profesionale
Nr 141 dt
2-7-03

NE FUSHA TE NDRYSHME

Ne fushen e tregtimit te pjeseve te kembimit per makineri e automjete, plehra kimike, hapje pika servisi, lavazho, agjensi turistike, bar- bufe, restorante, motel, transport mallrash dhe pasagjeresh.

Ne keto rrethana ligjore kerkojme nga Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane te

VENDOSE

1. Pranimin e kerkeses.
 2. Te urdheroje depozitimimin e vendimit nr. 2 date 21 shkurt 2005 te Ortakut te vetem per shtese te objektit te veprimtarise se Shoqerise „ JONI „ SHPK. Prane Regjistrat Tregetar te kesaj Gjykate.
- Kerkeses i bashkalidhen dhe dokumentat e nevojisme per keto veprime

KERKUESI

ADMINISTRATORI I SHOQERISE „ JONI“ SHPK

DIOGJEN QEVA:



[Handwritten signature]
SHPK "JONI"
Imp Exp
Pogradec ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE POGRADEC.

Nr: 124 Rep.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Pogradec, sot ne daten 26.02 2005 para meje Noterit u paraqit personalisht Administratori i Shoqerise „ JONI „ SHPK Diogjen Zarif Qeva i datlindjes 1968 lindur e banues ne Verdove- Pogradec, madhor me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova ne baze te leternjoftimit perkates, i cili deklaroi se kerkesa sam me siper eshte redaktuar me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkroi ate -pa verejtje. Une Noteri vertetoj nenshkrimin sipas ligjit.

NOTERI

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA „ JONI „ SHPK POGRADEC

V E N D I M
NR.2 DATE 21 SHKURT 2005 I ORTAKUT TE VETEM

Sot ne daten 21 shkurt 2005 ne seline e Shoqerise“ JONI shpk ne fshatin Verdove. Komuna Bucimas- Pogradec, si Ortak i vetem i kesaj Shoqerie mora ne shqyrtim, mora ne shqyrtim kete

Rend Dite.

Shtimin e objektit te veprimtarise se Shoqerise dhe sa me siper

V E N D O S A

1. Shtimin e objektit te veprimtarise se shoqerise

NE FUSHEN E STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE :

1. Per hartimin e planeve e te menaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike dhe kullotave.
2. Per hartimin e projekteve e te pyllizimit
3. Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve.
4. Per hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrueshem te pyjeve.
5. Per hartimin e projekteve te menaxhimit te pellgjeve ujembledhes

NE FUSHEN E ZBATIMIT TE PUNIMEVE PYJORE


1. Per pylllölözime (fidanishtet, grumbullimin e trajtamin e farerave pyjore, punimet pergatiore , mbjellje fidanash)
2. Per perimiresimin e pyjeve(ricungimin e trajtim pyjesh me prerje kulturore)
3. Per shfrytezimin e qendrueshem te pyjeve.
4. Per sistemimet malore.
5. Per ndertimin e rrugeve pyjore.
6. Per ushtrimin e gjuetise sportive e turistike te faunes se eger.
7. Per mbrojtjen nga semundjet, demtuesit dhe zjarret.
8. Per punimet ne kullota e livadhe dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota e livadhe.
9. Punime ne zonat e mbrojtura.
10. Tranzitim , perpunim dhe shpermdarje e druve te zjarrit, solarit, etj .
11. Te kryeje punime ne fushen e pyjeve dhe ne pyjet komunale.

NE FUSHA TE NDRYSHME

Ne fushen e tregetimit te pjeseve te kembimit per makineri e automjete, plehra kimike , hapje pika servisi, lavazho, agjensi turistike, bar- bufe, restorante, motel, transport mallrash dhe pasagjeresh

2. Te depozitohet vendimi ne Gjykatën e shkallës së Parë, Tirane , per tu bere ndryshimet perkatese ne Regjistrimin Tregetar te kesaj gjykate.

ORTAKU I VETEM
DIOGJEN QEVA


SHPK "JONI"
Imp Exp
Pogradec ALBA



**DREJTORIA E PERGJITHSHME
E PYJEVE DHE KULLOTAVE
KOMISIONI I LEJEVE PROFESIONALE**



LEJE PROFESIONALE

Personit Juridik Nr 141

Z. Diogjen QELVA, Rrethi POGRADEC

I jepet leja profesionale "JONI" sh.p.k, si person juridik, me drejtues teknik,

*Z. Qani Bushi me leje profesionale Nr. 141 dhe regjistrohiet ne regjistrin themelstar nga data
02.07.2003, si me poshte:*

Ne fushen e zbatimit te punimeve pyjore:

1. per pyshizimet -(fidanishtet, grumbullimin e trajtimin e sarrerace pyjore, punimet perqatitore e mbjellje fidanashi),
2. per permiresimin e pyjecentricungime e trajtim pyjesh me prerje kulturore),
3. per shfrytezimin e qendrueshem te pyjeve
4. per sistemimet malore
5. per ndertimin e rrugeve pyjore
6. per punimet ne kullota , livadhe dhe ndertimin e meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe




Republika e Shqiperise
Dhama Noterisë Pogradec

Nr Rep 127 Dt 26.07.2003

VËRTETIM

Vërtetohet njësinë me
originalin




Kjo leje eshte e vlefshme deri me 02.07.2006

SEKRETARI

Emilja Bibolli

KRYETARI

Dr. Maxhar Bida



158.16

GJYKATËS SE RREGJISTRIT TË TREGËTARË

T I R A N Ë

Unë i nënshkruari Diogjen Zarif Qeva , lindur dhe banues në fshatin Vërdovë të rrethit Pogradec , i datëlindjes 22 Janar 1968, me cilësinë e ortakut të vetëm , pranor i aktivitetit privat të personit juridik në fushën e shfrytëzimit , përpunimit , transportit të lëndës drusore e produkteve të tjera industriale prej druri si dhe të tregëtisë të artikujve industriale dhe ushqimore me shumicë dhe pakicë , improt eksport etj. në rrethin e Pogradecit , parashtroi kërkesën time si vijon:

Duke qënë se gjatë kësaj periudhe më janë krijuar mundësitë e mia financiare si dhe duke patur dëshirën që të ushtroi aktivitet tregëtar privat në fushën e shfrytëzimit , përpunimit dhe transportit të lëndës drusore e të produkteve të tjera prej druri si dhe në fushën e tregëtisë të artikujve industriale dhe ushqimore me shumicë dhe pakicë , aktivitete në të cilat unë deri tani kam punuar si i punësuar në firma të ndryshme private apo dhe me pjesëmarrje financiare, si dhe duke shprehur dëshirën për të respektuar kërkesat e ligjeve të shtetit shqiptar , të cilat i kam shprehur si në Statutin e shoqërisë apo dhe aktin e themelimit të shoqërisë, kërkoj që: nga anajuaaj të më bëhet rregjistrimi i shoqërisë tregëtare që unë po krijoj.

Ngelem me shpresë se kërkesa ime do të merret parasysh.

Pogradec, më 4.9.1996

ME RESPEKT

Diogjen Zarif Qeva

*Les regjistruar
akt. G-P-P
Hypokrite
M. Deshi
M. Dava*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA POGRADEC
Nr. 4134 Rep.

VËRTETIM NËN SHKRIMI

Sot në datën 5.9. 1996 u paraqit para meje Notere Burbuqe Sala zoti Diogjen Qeva , i datëlindjes 22.1.1968, lindur dhe banues në fshatin Vërdovë të rrethit Pogradec , madhor e i aftë për të kryer veprime juridike , për identitetin e të cilit u sigurova nga letër njoftimi personal , i cili deklaroi se firma në këtë kërkesë është e tij.

NOTERIA POGRADEC
NOTERE BURBUQE SALA
TEL. NR. 382



NOTERE
Burbuqe Sala
[Signature]